

## **Regjistrimet në çerdhe komunale për vitin shkollor 2024/2025** **Si kryhet regjistrimi on-line**

Për të kryer regjistrimin on-line (shërbimi është aktiv nga ora 10.00 e datës 18 janar 2024 deri në orën 20 të datës 18 shkurt 2025) është e nevojshme që të keni **një** nga dokumentet e mëposhtëme:

**-Sistemin Publik për menaxhimin e Identitetit Dixhital (SPID)**

<http://servizi.comune.fi.it/servizi/servizi-spид>

**- Librezën shëndetësore të rajonit të aktivizuar** në sportelet e ASL-it të Qarkut të Toskanës (Regione Toscana).

Për informacione <http://www.regione.toscana.it/servizi-online/servizi-sicuri/carta-sanitaria-elettronica>

**- Kartën Nacionale të Shërbimeve (CNS) \***

<http://www.regione.toscana.it/-/carta-nazionale-dei-servizi>

\* Për disponuesit e Librezës Shëndetsore Rajonale dhe Kartës Nacionale të Shërbimeve të aktivizuar është e nevojshme të dispononi lexuesin smart card i cili mund të blehet në Qëndrat Shëndetsore (ASL), dhe është e mundur të hyni në Shërbimin Online **vetëm** nga pc juaj.

**- Kartë identiteti elektronike (CIE)**

<https://servizi.comune.fi.it/servizi/scheda-servizio/carta-di-identita-elettronica-cie>

\*\*\*\*

Pasi të keni një nga këto mjete (karta shëndetësore e aktivizuar SPID ose CNS ose CIE) do të mund të përdorni shërbimin online të dedikuar për regjistrimin në çerdhe përmes lidhjes së mëposhtme

<http://servizi.055055.it/iscrizionematernefe/>

**Shërbimi do të jetë aktiv nga ora 10:00 e datës 18 janar 2025 deri në orën 20:00 të datës 10 shkurt 2024**

**Familjet e huaja** të cilat janë rezidente në Firenze dhe kanë vështirsi në kuptimin e gjuhës italiane ose që sidoqoftë kanë nevojë për mbështetje dhe për konsultim, mund ti drejtohen **Sportelit të Emigrimit** Lagjia 5 Villa Pallini, Rruga Baracca 150 P, ku do të gjejnë asistencën e nevojshme për plotësimin e modularit të regjistrimit on line dhe në praninë e mundshme të ndërmjetësit të gjuhës dhe kulturës përkatëse.

Për të lënë **një takim** duhet të kontaktoni direkt **Sportelin e Emigrimit** në numrin 055 2767078 – 055 2767079

Mund të telefononi edhe për informacione të përgjithshme.

<https://servizi.comune.fi.it/servizi/scheda-servizio/sportello-immigrazione-0>

Kërkesa e regjistrimit paraqitet në formën e vetëdeklarimit dhe deklarimit të aktit noterial, sipas D.P.R nr. 445/2000 dhe modifikimet e plotësimet pasuese, me përjashtim të disa situatave për të cilat do të kërkohet dokumentacioni specifik.